

Propozim

Në bazë të nenit 15 alineja 1 të Ligjit për veprimtari komunale ("Fletorja Zyrtare e MZ" nr. 55/16, 74/16, 2/18, 66/19, dhe 40/19) nenit 38 alineja 1 pika 2 e Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Fletorja Zyrtare e MZ", nr. 2/18 dhe 34/19 dhe 38/20) dhe nenit 58 alineja 1 pika 2 e Statutit të Komunës së Ulqinit ("Fletorja Zyrtare MZ – dispozitat komunale", numër 48/19) Kuvendi i Komunës së Ulqinit, në mbledhjen e mbajtur _____ 30.12. _____ 2020 sollti

VENDIMIN

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT NË VENDIMIN PËR NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E VENDIMIT PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË UJIT DHE SHËRBIMEVE PËR SHFRYTËZIMIN E KANALIZIM TË QYTETIT NË TERITORIN E KOMUNËS SË ULQINIT

Neni 1.

Jepet pëlqimi në Vendimin për ndryshimet dhe plotësimet e Vendimin për përcaktimin e çmimit të ujit dhe shërbimeve për shfrytëzimin e kanalizimit të qytetit në teritorin e Komunës së Ulqinit, të cilën e ka sjell Bordi i Drejtorëve i SHPK "Ujësjiellës dhe Kanalizim" Ulqin, numër 973 i datës 6.10.2020.

Neni 2.

Vendimi i SHPK "Ujësjiellës dhe Kanalizim" Ulqin, numër 973 i datës 6.10.2020 është pjesë përbërëse e këtij Vendimit.

Vendimi nga alineja 1 e këtij nenit sillet pas marrjes parapraket të pëlqimit nga ana e Agjencionit Rregullator për Energjetik dhe Rregullimin e Veprimtarive Komunale numër 20/3037-23 i datës 19.11.2020.

Neni 3.

Ky Vendim hynë në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit në "Fletoren Zyrtare të Malit të Zi – dispozitat komunale"

Numri 02-238/20-10

Ulqin, 30.12.2020

KUVENDI KOMUNAL I ULQINIT

**Kryetar,
Dr. Ilir Çapuni**

Në bazë të nenit 54 të Ligjit mbi veprimtaritë komunale („Fletore zyrtare e Malit të Zi“,nr.055/16 datë 17.08.2016,074/16 date 01.12.2016,002/18 datë 10.01.2018,066/19 datë 06.12.2019),Metodologjisë për përcaktimin e çmimit për kryerjen e veprimtarive të rregulluara komunale („Fletore zyrtare e Malit të Zi“,nr.056/20 datë 15.06.2020),nenit 30 pika 1 alineja 9 e Statutit të SH.p.k."Ujësjetllës dhe kanalizimi"Ulqin,bie këtë :

VENDIM
për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit
për përcaktimin e çmimit të ujit dhe shërbimit për shfrytëzimin e kanalizimit të qytetit
ne teritorin e Komunës së Ulqinit

Neni 1.

Me këtë vendim përcaktohn cmimet e reja shitese per kompensimin e konsumit të ujit nga ujësjetllësi publik dhe shfrytezimin e kanalizimit të qytetit ne teritorin e Komunes se Ulqinit.Të gjitha organizatat ekonomike,institucionet,hotelerite,ndermarrjet publike,sipërmarrësit dhe qytetarët janë të obliguar që për shërbimet e konsumit dhe shfrytëzimit të kanalizimit të paguajn kompensimin sipas tarifave të përcaktuara me poshtë nga ky vendim:

Neni 2.

Në përputhje me metodologjinë për përcaktimin e çmimit për kryerjen e veprimtarive të rregulluara komunale,shfrytëzuesit janë të obliguar të paguajn kompensimin për konsumin e ujit dhe shfrytëzimin e kanalizimit të qytetit në mënyrën dhe sipas çmimit të përcaktuar si vijon:

<u>Pjesa fikse e çmimit (PFC)=1/2/12</u>	0,9470
<u>Pjesa variable e çmimit (PVC)=(3-(2*5*12))/4</u>	
Për persona fizik:	0,8515
Për persona juridik:	1,7615

<u>Pjesa fikse e çmimit (PFC)=1/2/12</u>	0,1381
<u>Pjesa variable e çmimit (PVC)=(3-(2*5*12))/4</u>	
Për persona fizik:	0,2836
Për persona juridik:	0,7942

Neni 3.

Çmimet e përcaktuara më këtë vendim aplikohen nga data e dhëniës pëlqimit nga Kuvendi i Komunës se Ulqinit.

Kryetari i borit të drejtorëve,
Nailj Redza d.v.

